



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 372 Prot.

Tiranë, më datë 29.04.2022

VENDIM
Nr. 137, datë 29.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, datë 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.04.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit “B.M-Konstruksion” sh.p.k. për rinovimin e Licencës si person juridik me Nr. R.SH.39 (N-), në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale (A), me drejturs teknik Z.Adrian Kalamishi, në nënkategoritë:
 - N-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
 - N-Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
 - N-Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
 - N-Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - N-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
 - N-Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Rudina ZOTO

KRYETAR

Elva MARGARITI

